



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2019:082045 C. nr. 277/2018
Datë: 27.05.2024
Numri i dokumentit: 05737458

GJYKATA THEMELORE PRIZREN, gjyqtari Atdhe Berisha, në çështjen juridiko-kontestimore të paditësit M.G., J.G., H.G., H.G. dhe B.G., të gjithë nga Prizreni, kundër të paditurit, T.K. nga Prizreni, për vërtetim të pronësisë, jashtë seance, me datë 27.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Hedhet poshtë padia në këtë çështje kontestimore.

A r s y e t i m

Paditësit M.G., J.G., H.G., H.G. dhe B.G., të gjithë nga Prizreni, të gjithë nga Prizreni, kanë paraqitur padi për vërtetimin e pronësisë, kundër të paditurit T.K. nga Prizreni.

Për këtë çështje kontestimore gjykata ka mbajtur seancën përgatitore në të cilën ka marr pjesë paditësi Jakup Gashi, ndërsa paditësit tjerë nuk kanë marr pjesë.

Gjithashtu në atë seancë nuk ka marr pjesë pala e paditur, nga fletëkthesa për dorëzime personale ekziston konstatimi “pala e panjohure në këtë adresë”. Fakt i cili pohohet edhe nga vetë paditësi J.G. i cili e njofton gjykatën që i padituri ndodhet në Itali, mirëpo adresën e banimit nuk e dinë.

Me qëllim të procedimit të kësaj çështje, në kuptim të nenit 79 par. 3 germa (a) lidhur me nenin 81 par. 2 dhe nenit 102 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata gjatë seancës përgatitore të datës 14.03.2024, ka marr aktvendim me të cilën e ka detyruar palën paditëse që në afat brenda pesëmbëdhjetë dite nga dita e marrjes së këtij aktvendimi, në arkën e kësaj gjykate, të deponon shumën prej 1.500,00 € me qëllim të pagimit të shpërblimit për përfaqësues të përkohshëm, të cilin do ta cakton gjykata nga radhët e avokatëve, duke e njoftuar palën paditëse lidhur me pasojat e mos veprimit sipas atij aktvendimi.

Duke pasur parasysh që pala paditëse në afatin e paraparë nuk deponon shumën e caktuar nga gjykata, gjykata në kuptim të nenit 391 par. 1 germa (g) lidhur me nenin 387 par. 1 germa (q) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

C. nr. 277/2018 datë 27.05.2024

Gj y q t a r i,
Atdhe Berisha

UDHËZIME PËR ANKESË: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur mund të ushtron ankesë, në Gjykatën Apelit në Prishtinë, brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, përmes kësaj gjykate.